EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7869
E shtunë, 24 gusht 2024
Çmimi 0. 50 €

Largimi i Emmersonit, Mahmuti: Goditja më e rëndë ndaj luftës çlirimtare

FAQE 5

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHEFI I CIA-S, WILLIAM BURNS PËRFUNDON VIZITËN DYDITORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS FAQE 4

SHEFI I CIA-s PËRMBYLL VIZITËN NË KOSOVË

- Osmani: Aleanca me Shtetet e Bashkuara, garancë për siguri, paqe e sukses!

- Qeveria: Vizita e Burnsit përfaqëson një moment të rëndësishëm historik në marrëdhëniet bilaterale Kosovë - ShBA

Shefi i CIA-s, William Burns, ka qëndruar në Kosovë në një vizitë dyditore. Gjatë kësaj vizite, ai është takuar me presidenten Vjosa Osmani, kryeministrin Albin Kurti dhe shefin e AKI-së, Petrit Ajeti.

Lidhur me këtë vizitë nuk është dhënë asnjë detaj nga administrata amerikane. E para që ka folur për këtë vizitë ka qenë presidentja Osmani, e cila nuk ka dhënë asnjë detaj, por ka thënë se aleanca e Kosovës me ShBA-në është garancë për siguri, paqe dhe sukses. Ndërsa Qeveria e Kosovës e ka vlerësuar vizitën e shefit të CIA-s si "moment të rëndësishëm historik" në raportet ndërmjet dy shteteve mike

FORMIMI I ASOCIACIONIT NË KËMBIM TË KUJT? F. 3



HARADINAJ: SMAJL LATIFI, SHEMBULL I KRYETARIT TË MIRË F. 6

OPINION

FEJTON | "GEORGE F. KENAN: MEMOARE 1925 - 1950" (7)

KLASA SUNDUESE RUSE RESPEKTON VETËM TË FORTIT! F. 10

Shkruan: Prof.dr. Agim ZOGAJ

AKTUALE

HARRISI ZOTOHET PËR "NJË RRUGË TË RE PËRPARA" F. 2

22 KANDIDATË FILLOJNË RRUGËTIMIN E TYRE PËR T'U BËRË KADETË TË FSK-së F. 7

KURTI DHE DIBRANI DISKUTOJNË PËR PROGRAMET REHABILITUESE NË BURGJET E KOSOVËS F. 7

MSH-ja: SPITALI I RI I FERIZAJT DO TË BËHET CILËSOR DHE I SIGURT F. 6

EKONOMI

LDK-ja: NAGIP KRASNIQI DHE MARTIN BERISHAJ KANË QENË NË KRYE TË MAFISË ENERGJETIKE F. 8

ASK-ja: MË SHUMË THËNGJILL TË PRODHUAR NË QERSHOR 2024 SESA VITIN E KALUAR F. 8

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Robert F. Kennedy Jr tërhiqet nga gara presidenciale

UASHINGTON, 23 GUSHT - Kandidati i pavarur për president të ShBA-së, Robert F. Kennedy Jr, ka dorëzuar dokumentet e nevojshme për t'u tërhequr nga zgjedhjet presidenciale të shtetit të Arizonës.
Sipas informacioneve, kandidati dëshiron një marrëveshje me Donald Trump, në të cilën ai do të mbështeste kundërshtarin e tij republikan në këmbim të një vendi në një administratë eventuale të Trump.
Kennedy, 70 vjeç, djali i politikanit të ndjerë demokrat dhe Prokurorit të Përgjithshëm të ShBA-së, Robert F. Kennedy dhe nipi i presidentit të ndjerë John F. Kennedy, kishte filluar fushatën e tij presidenciale si demokrat, duke kërkuar nominimin presidencial të partisë.

Harrisi zotohet për "një rrugë të re përpara"

ÇIKAGO, 23 GUSHT - Nëpresidentja amerikane, Kamala Harris, u ka bërë thirrje amerikanëve që të refuzojnë ndarjet politike, duke thënë se ka shans për "një rrugë të re përpara". Gjatë pranimit të nominimit të Partisë Demokratike për të garuar për presidente kundër republikanit, Donald Trump në zgjedhjet e nëntorit, Harrisi është zotuar se, nëse zgjedhet, do të jetë presidente për të gjithë amerikanët.
Gjatë fjalimit në Kuvendin Kombëtar të demokratëve, nënpresidentja ka argumentuar se historia e saj personale dhe karriera si prokurore e bëjnë atë person të kualifikuar në mënyrë unike që të mbrojë interesat e amerikanëve kundër ish-presidentin Trump, i cili, sipas Harrisit, ka në mendje vetëm interesat personale.
"Kombi ynë me këto zgjedhje ka një mundësi të çmuar që të tejkalojë hidhërimin, cinizmin dhe betejat ndarëse të së shkuarës. Një shans për një rrugë të re përpara. Jo si anëtar të ndonjë partie apo fraksioni, por si amerikanë", ka thënë Harrisit gjatë fjalimit 40-minutësh të Kuvendit partiak.
Harrisi është gruaja e parë me ngjyrë dhe personi i parë me prejardhje nga Azia Jugore që pranon nominimin e një partie të madhe për të garuar për Shtëpinë e Bardhë. Nëse zgjidhet, ajo do të bëhej gruaja e parë presidente e ShBA-së.
Adresimi i saj dhe Konventa e demokratëve në përgjithësi synonte që t'iu drejtohej një pjese të madhe të amerikanëve, jo vetëm mbështetësve të partisë së saj, të cilët kanë shprehur mbështetje për të pasi presidenti Joe Biden, ka hequr dorë nga gara për rizgjedhje.
Ajo ka bërë disa thirrje që u drejtoheshin një numri të madh votuesish që janë të pakënaqur me zgjedhjet e dy partive kryesore për garën për Shtëpinë e Bardhë, veçmas ajo u është drejtuar personave që janë të pakënaqur me Trumpin. "Amerikë, rruga që na solli këtu në javët e fundit, padyshim që ishte e papritur. Por, unë nuk e kam për herë të parë një rrugëtim të tillë", ka thënë Harrisi.
Gjatë adresimit, ajo ka folur për jetesën me nënën në një banesë të vogël të San Franciskos, pas shkurorëzimit të prindërve. Ajo po ashtu ka treguar historinë e shoqes së saj të ngushtë në shkollën e mesme, Wanda, e cila i kishte treguar Harrisit se po abuzohej nga njerku i saj dhe më pas Wanda kishte shkuar të jetonte me familjen e Kamala Harrisit. "Kjo histori është një prej arsyeve pse u bëra prokurore. Për të mbrojtur njerëzit sikurse Wanda", ka thënë Harrisi.
Duke folur për karrierën e saj si prokurore, më pas si prokurore e përgjithshme e shtetit, senatore dhe tani nënpresidente, Harrisi ka thënë se "e gjithë karriera ime e ka pasur vetëm një klient: popullin".
Ndërsa ka thënë ajo, Trumpi gjithmonë ka vepruar në interes "të vetëm një klienti që ai ka pasur: vetes". Gjatë Kuvendit të demokratëve, Harrisi u është drejtuar direkt republikanëve që nuk e mbështesin Trumpin dhe u ka kërkuar që t'i lënë anash përkatësinë politike dhe të mos e mbështesin Trumpin. "E di që shumë njerëz që kanë pikëpamje të ndryshme politike po na shikojnë sonte. Unë dua që iu ta dini se premtoj se do të jem presidente për të gjithë amerikanët. Premtoj se do të jem presidente për të gjithë amerikanët dhe do të mbroj

parimet e shenjta kushtetuese të Amerikës, parimet themeltare, nga sundimi i ligjit dhe zgjedhjet e lira e deri te transferimi paqësor i pushtetit", ka thënë ajo.
Duke kujtuar karrierën e saj si prokurore, ajo iu referuar disa herë "qëllimit eksplicit" të Trumpit që të lirojë të gjithë ata që sulmuan policët gjatë sulmit të 6 janarit të vitit 2021 ndaj ndërtesës së Kongresit amerikan, të burgosë kundërshtarët politikë dhe të përdorë ushtrinë kundër popullit amerikan. "Vlerësojeni se çfarë synon të bëjë ai nëse vjen sërish në pushtet", ka thënë Harris.
Trumpi që ka thirr në "Fox News" pas fjalimit të Harrisit, u është përgjigjur deklaratave të saj duke pyetur: "Pse ajo nuk i bëri gjërat për të cilat po ankohet. Shumë ankesa. Ajo nuk foli për Kinën. Nuk foli për krimin", ka thënë Trumpi.
Në fjalimin e saj, që është më i detajuari sa i përket sigurisë kombëtare që kur është bërë kandidate për presidente, Harris është zotuar se do të forcojë raportet e ShBA-së me aleatët e NATO-s, duke thënë se shteti do të vazhdojë të mbështesë Ukrainën në luftën kundër Rusisë.
Trumpi dhe kandidati i tij për nënpresident, JD Vance, në vazhdimësi kanë vënë në pikëpyetje mbështetje e ShBA-së për Ukrainën.
"Unë kur nuk do të lëkundem nga mbrojtja e sigurisë së Amerikës dhe idealeve sepse në betejën mes demokracisë dhe tiranisë e di se ku qëndron ShBA-ja dhe se ku e ka vendin", ka thënë Harrisi.
Nënpresidentja po ashtu është zotuar se do të punojnë drejt dhënies fund të luftës mes Izraelit dhe Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja, duke thënë se mund ta stabilizonte pjesën tjetër të rajonit, duke shtuar se nuk do të hezitojë të mbrojë forcat amerikane nga agresioni i Iranit apo i ndonjë armiku tjetër.
Përderisa ajo është zotuat "se gjithmonë do të mbrojmë të drejtën e Izraelit për vetëmbrojtje" pas sulmit të Hamasit më 7 tetor dhe do të punojë për lirimin e pengjeve dhe për armëpushim, ajo foli edhe për civilët palestinezë.
"Ajo çfarë ka ndodhur në Gazë në 10 muajt e fundit është e tmerrshme, shumë jetë të pafajshme janë humbur. Njerëz të uritur e të dëshpëruar që largohen vazhdimisht për të gjetur një strehë të sigurt. Shkalla e vuajtjes është e tmerrshme", ka thënë Harrisi.
Gjatë adresimit ajo po ashtu është zotuar se do të rivendosë vendimin për qasje në abort në mbarë vendin, pasi Gjykata Supreme ka hequr të drejtën e mbrojtur kushtetuese për abort. Harrisi ka kritikuar Trumpin dhe republikanët që kanë mundësuar ndalimin e abortit në dhjetëra shtete dhe janë zotuar se do ta ndalojnë edhe në shtete të tjera.
Pasi Harrisi zëvendësoi Bidenin si kandidate për presidente, ajo është përballur me kritika se shmang disa politika specifike. Por, gjatë Kuvendit Kombëtar të demokratëve ajo ka bërë premtime për disa politika kyçe sikurse zgjerimi i të drejtës së votimit, ulja e kostos së jetesës, fuqizimi i klasës së mesme përmes shkurtimit të taksave dhe për sigurinë e kufirit. /Associated Press

Përmbytjet në Bangladesh, 13 njerëz të vdekur dhe 4.5 milionë të prekur

Dhaka, 23 gusht - Të paktën 13 njerëz në Bangladesh janë vrarë dhe 4.5 milionë janë prekur nga përmbytjet e shkaktuara nga shirat e dendur, ka thënë të premten Ministria e Menaxhimit të Fatkeqësive dhe Ndihmës. Kombi i Azisë Jugore me 170 milionë banorë, i kryqëzuar nga qindra lumenj, ka parë përmbytje të shpeshta në dekadat e fundit. Është ndër vendet më të cenueshme nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike , sipas Indeksit Global të Rrezikut Klimatik.
Një buletin nga Ministria e Fatkeqësive të premten, ka bërë me dije se "4.5 milionë njerëz janë prekur dhe 13 njerëz kanë vdekur në të gjithë vendin". Sipas buletinit, gati 190 mijë të tjerë u dërguan në strehimoret e ndihmës emergjente. Në total, 11 nga 64 rrethet e vendit u prekën nga përmbytjet, ka thënë buletini.
Feni, rreth 100 kilometra në veriperëndim të qytetit kryesor port të Chittagong, u godit më së shumti. "Është një situatë katastrofike këtu. Ne po përpiqemi të shpëtojmë sa më shumë njerëz që mundemi", vullnetari i shpëtimit.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Formimi i Asociacionit në këmbim të kujt?

PRISHTINË, 23 GUSHT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, beson se Serbia është tërhequr nga marrëveshja për normalizim marrëdhëniesh me Kosovën, dhe konsideron që nëse vendi i saj duhet ta formojë Asociacionin e komunave me shumicë serbe, aleatët ndërkombëtarë duhet të ofrojnë garanci të sigurisë.

"Zbatimi i marrëveshjes pa garanci të sigurisë, pa anëtarësim në organizata ndërkombëtare, nuk ka asnjë kuptim", ka thënë Osmani për "Radion Evropa e Lirë", duke përmendur nevojën e anëtarësimit të Kosovës në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) dhe në Këshillin e Evropës, si dhe aktivizimin e fushatës së njohjeve, mes tjerash.

Profesori në Universitetin Johns Hopkins në Shtetet e Bashkuara, njëherësh njohës i zhvillimeve në Ballkan, Daniel Serwer, e pëlqen qasjen e saj. "Ajo ka plotësisht të drejtë kur dëshiron të ndryshojë theksin, nga zbatimi i një marrëveshjeje që nuk ekziston në diskutimet me miqtë e Kosovës se çfarë duhet të bëjë (Kosova) për të arritur aty ku synon".

Kosova dhe Serbia kanë arritur pajtueshmëri për marrëveshjen drejt normalizimit të marrëdhënieve në muajt e parë të 2023-tës, por drejt zbatimit të saj nuk janë bërë hapa.

Edhe më pak premtues shihen muajt vijues deri te funksionalizimi i udhëheqjes së re të Bashkimit Evropian dhe i administratës së re amerikane, pas zgjedhjeve presidenciale të nëntorit atje.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë më 21 gusht, pas një takimi me senatorin Chris Murphy në ShBA, se Kosova është e përkushtuar për zbatimin e marrëveshjes, por për t'u zbatuar, ajo duhet të pranohet edhe nga Serbia.

Në dhjetor të vitit të kaluar, ish-kryeministrja e Serbisë, Ana Bërnabiq, u kishte dërguar një letër zyrtarëve evropianë, në të cilën konfirmoi se Serbia ka vija të kuqe kur bëhet fjalë për zbatimin e Marrëveshjes për normalizim.

Asociacioni – temë e zvarritur për më shumë se një dekadë

Çështja e formimit të Asociacionit merr vëmendje të vazhdueshme që prej vitit 2013. Palët kanë arritur në të kaluarën marrëveshje për formimin e tij, për të janë hartuar drafte e propozime prej palëve të ndryshme, por Asociacioni nuk është formuar kurrë. Osmani ka thënë se Kosova nuk po heziton ta dërgojë një draft të Perëndimit për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, por se është kundër zbatimit të njëanshëm të marrëveshjes.

Marrëveshja kërkon respektim të integritetit territorial të të dyja vendeve, dhe që Serbia të mos e kundërshtojë procesin e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, ka deklaruar disa herë që Serbia as nuk do ta njohë shtetësinë e Kosovës, e as nuk do të lejojë anëtarësimin e saj në Organizatën e Kombeve e Bashkuara.

Serweri beson se Kosova duhet ta formojë Asociacionin vetëm në fazat e fundit të dialogut, kur Serbia të njohë shtetësinë e Kosovës, dhe që garancitë e sigurisë për Kosovën duhet të bëhen prej aleatëve nëpërmjet një dokumenti zyrtar, sepse shqetësohet se Beogradi mund ta keqpërdorë atë.

Reagimet e ShBA-së dhe BE-së për qasjen

Osmani ka thënë se ka një vit që i ka nisur diskutimet me aleatët ndërkombëtarë në këtë drejtim, por nuk ka marrë përgjigje konkrete.

As "Radio Evropa e Lirë" nuk ka marrë përgjigje nga NATO-ja pas kërkesës që t'i komentojë synimet e Kosovës. Ndërsa një zëdhënës i Departamentit amerikan të Shtetit, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se pret që Kosova dhe Serbia t'i zbatojnë marrëveshjet e arritura në dialog, pa vonesa dhe pa parakushte: "Për Kosovën, kjo përfshin themelimin e Asociacionit".

Në anën tjetër, zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, tha se zbatimi i marrëveshjes lidhet me rrugën e dy vendeve drejt anëtarësimit në BE, dhe se "është për keqardhje që është arritur aq pak përparim në përmbushjen e obligimeve".

Dokumenti i marrëveshjes nuk është nënshkruar asnjëherë nga palët, por BE-ja insiston që ajo është obliguese, sipas të drejtës ndërkombëtare.

"Dialogu ka dështuar"

Daniel Serwer beson se duhet pranuar nga të gjithë se dialogu i Brukselit ka dështuar dhe se duhet ndryshuar agjendën dhe prioritetet, pasi dy vende fqinje duhet të bisedojnë me njëra-tjetrën. "Prioriteti serioz është ruajtja e integritetit territorial dhe sovranitetit të të gjitha vendeve të Ballkanit. Kosova duhet të njihet nga të gjitha vendet në botë dhe të pranohet në Kombet e Bashkuara", ka thënë ai.

I pyetur se si mund të ndryshojë dinamika e dialogut pas janarit, kur në ShBA merr detyrën presidenti i ri, ai tha se njohuritë paraprake të zyrtarëve të rinj për Ballkanin nuk janë të domosdoshme për sukses. "Kam këshilluar shumë ambasadorë amerikanë që janë nisur drejt Ballkanit, disa prej të cilëve nuk janë marrë asnjëherë me rajonin dhe ia kanë dalë shumë mirë. Nuk marr asnjë përgjegjësi për këshillimin e individëve që kanë dështuar. Ata kanë biseduar me mua, por nuk i kanë ndjekur këshillat e mia", ka thënë Serwer.

Kush do të merret me çështjen e dialogut?

Zyrtarë të lartë të Kosovës presin trajtim të barabartë nën udhëheqjen e re, diçka që ata vlerësojnë se nuk ka ekzistuar në vitet e fundit.

Ndër emrat e rinj dihet ai i Kaja Kallasit si kryediplomate e BE-së, dhe i Alexander "Sasha" Kasanofit si i dërguar amerikan për Ballkanin. Të dërguarit të BE-së për dialogun, Mirosllav Lajçak, i është zgjatur mandati deri në fund të janarit.

Edona Maloku-Bërdyna, ambasadore e re e Kosovës në Portugali

Prishtinë, 23 gusht - Edona Maloku-Bërdyna është emëruar ambasadore e re e Kosovës në Portugali.Lajmin e ka bërë me dije ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla. "Edona Maloku Bërdyna është një figurë e shquar në shkencat sociale, me një karrierë që bashkon hulumtimin akademik, praktikën e aplikuar dhe zhvillimin e politikave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ajo ka doktoraturë në Psikologji/Shkenca Sociale nga Universiteti Leiden në Holandë, ku edhe ka përfunduar Masterin e Shkencave me vlerësimin më të lartë të dhënë në universitetet holandeze (Cum Laude)", ka shkruar Gërvalla në "Facebook".

Gërvalla ka thënë se puna e Maloku-Bërdynës është njohur dhe vlerësuar në shkallë globale, "duke përfshirë çmimin prestigjioz Otto Klineberg dhe disa njohje ndërkombëtare për ndikimin e saj në ndryshimin social dhe drejtësinë shoqërore". "Me këtë përvojë të pasur dhe vizion të qartë, jemi të bindur se nën drejtimin e saj, marrëdhëniet e Kosovës me Portugalinë do të arrijnë nivele të reja të zhvillimit dhe bashkëpunimit. Në arsim, kulturë, ekonomi dhe fusha të tjera kyçe, Maloku Bërdyna do të sjellë një perspektivë të freskët dhe energji të reja për të fuqizuar këto lidhje", ka shkruar ajo.

Gërvalla ka falënderuar ambasadorin e deritashëm për punën në Portugali. "Një falënderim për ambasadorin e deritanishëm, Ylber Kryeziu, për angazhimin dhe kontributin e tij gjatë këtij shërbimi jashtë vendit", ka shkruar Gërvalla.

SHEFI I CIA-S, WILLIAM BURNS PËRFUNDON VIZITËN DYDITORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Shefi i CIA-s përmbyll vizitën në Kosovë

-Osmani: Aleanca me Shtetet e Bashkuara, garancë për siguri, paqe e sukses!

-Qeveria: Vizita e Burnsit përfaqëson një moment të rëndësishëm historik në marrëdhëniet bilaterale Kosovë - ShBA

Shefi i CIA-s, William Burns, ka qëndruar në Kosovë në një vizitë dyditore. Gjatë kësaj vizite, ai është takuar me presidenten Vjosa Osmani, kryeministrin Albin Kurti dhe shefin e AKI-së, Petrit Ajeti. Lidhur me këtë vizitë nuk është dhënë asnjë detaj nga administrata amerikane. E para që ka folur për këtë vizitë ka qenë presidentja Osmani, e cila nuk ka dhënë asnjë detaj, por ka thënë se aleanca e Kosovës me ShBA-në është garancë për siguri, paqe dhe sukses. Ndërsa Qeveria e Kosovës e ka vlerësuar vizitën e shefit të CIA-s si "moment të rëndësishëm historik" në raportet ndërmjet dy shteteve mike

Lirim GECI

EPOKA E RE Prishtinë, 23 gusht - Shefi i Agjencisë Qendrore amerikane të Inteligjencës (CIA), William Burns, ka përmbyllur vizitën e tij dyditore në Kosovë, pas takimeve që ka zhvilluar në Prishtinë me krerët shtetërorë dhe udhëheqësin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI).

Mëngjesin e së premtes, për rreth një orë ka zhvilluar një takim me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës.

Pas këtij takimi, sipas ueb-faqes për gjurmimin e fluturimeve, "Flightradar", avioni i ushtrisë amerikane, me të cilin po udhëton Burns, është larguar nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, "Adem Jashari".

Qeveria e Kosovës e ka vlerësuar vizitën e shefit të CIA-s në Prishtinë si "moment të rëndësishëm historik" në raportet ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së. "Kjo vizitë përfaqëson një moment të rëndësishëm historik në marrëdhëniet bilaterale Kosovë – ShBA, ku u theksua përkushtimi i qeverisë dhe institucioneve të sigurisë dhe inteligjencës së Kosovës, me në krye AKI-në, për të avancuar bashkëpunimin me CIA-n. Vizita historike e drejtorit të CIA-s, z. William Burns, në Kosovë, vlerësohet lartë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ajo është dëshmi e marrëdhënieve të forta dhe të qëndrueshme midis dy shteteve dhe është një mundësi e artë për të thelluar bashkëpunimin strategjik, për paqen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë.", është thënë në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

Institucionet e sigurisë, inteligjencës dhe Qeveria e Kosovës është bërë me dije se janë të përkushtuara që të avancojnë bashkëpunimin me CIA-n. "Kryeministri Kurti e falënderoi drejtorin e CIA-s për mbështetjen e vazhdueshme dhe shprehu përkushtimin për thellimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, duke e njoftuar atë që vlerat amerikane, që ndërlidhen me demokracinë, sundimin e rendit dhe ligjit dhe orientimet e palëkundura Euroatlantike, do të mbeten shtyllat qendrore të qeverisjes së mirë e demokratike në Kosovë", ka njoftuar qeveria Kurti.

Takimi në mes të Kurtit dhe Burnsit pas kthimit të kryeministrit nga ShBA-ja, ku me ftesë të Institutit Kombëtar Demokratik, përcolli nga afër Kuvendin Kombëtar të Partisë Demokratike.

Burns të enjten është takuar në Prishtinë me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe me shefin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Petrit Ajeti.

Presidentja Osmani, tek të premten ka treguar për takimin me kreun e CIA-s, William Burns. "Aleanca me Shtetet e Bashkuara, garancë për siguri, paqe e sukses!

Kënaqësi që mirëprita dje në Republikën e Kosovës shefin e Agjencisë Qendrore amerikane të Inteligjencës (CIA), ambasadorin William Burns", ka shkruar Osmani në "Facebook".

Vizita e shefit të CIA-s në Kosovë pason vizitat që zyrtari kryesor i inteligjencës amerikane ka zhvilluar në Bosnje e Hercegovinë dhe Serbi.

Më 20 gusht, Burns është takuar me drejtorin e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Bosnje e Hercegovinës, Almir Xhuvo, dhe me anëtarët e Presidencës së Bosnjës, Denis Beqiroviq, Zhelko Komshiq dhe Zhelka Cvijanoviqit, anëtaren serbe të sanksionuar nga ShBA-ja.

Gjatë vizitës, është raportuar se Burns ka diskutuar edhe për retorikën secesioniste dhe veprimet e Millorad Dodikut, presidentit prorus të entitetit serb të Bosnjë e Hercegovinës, Republika Sërpska.

Një ditë më vonë, Dodiku ka deklaruar se "nuk e kam kundërshtuar kurrë" sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnje e Hercegovinës në përputhje me Marrëveshjen e Dejtonit, ndërkaq shkëputja "nuk ka qenë kurrë politikë e jona".

Sa i përket vizitës në Beograd, nuk dihet se me kë është takuar Burns.

Vizita e Burnsit në Kosovë ka pasur deklaratat e ambasadorit amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, se shteti i tij është sfiduar në disa aspekte nga Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti.

Selimi: ShBA-ja ka ndërprerë çfarëdo vizite të Qeverisë së Kosovës në Uashington DC

Prishtinë, 23 gusht - Ish-ministër i Punëve të Jashtme i Kosovës, Petrit Selimi, ka komentuar vizitën e William Burns, shef i CIA-s, në Kosovë, ku është takuar me presidenten Vjosa Osmani, kryeministrin Albin Kurti dhe shefin e Agjencisë së Kosovës (AKI) për Inteligjencë (AKI), Petrit Ajetin.

Selimi ka shkruar në platformën "X" se ShBA-ja ka ndërprerë çfarëdo vizite të Qeverisë së Kosovës në Uashington DC. "Kosova aktualisht është nën sanksione të BE-së, ShBA-ja ka ndërprerë çfarëdo vizite të Qeverisë së Kosovës në Uashington DC (përfshirë ambasadorin e ShBA-së që ka qenë i qartë për atë se s'ka takime për Kurtin në Uashington DC). Jemi bllokuar nga Gjermania dhe Franca për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Diçka duhet të ndryshojë dhe të ndryshojë shpejt. Ndoshta vizita e Burnsit sjell ndryshim", ka shkruar Selimi.

Skadon afati për konvertimin e patentë-shoferëve

Prishtinë, 23 gusht - Të premten ka skaduar afati për konvertimin e patentë-shoferëve të lëshuar nga Serbia në ato të Kosovës. Pas skadimit të afatit, më nuk do të tolerohen këto dokumente që Serbia i lëshon për qytetet e Kosovës.

Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, ka sqaruar për "Radion Evropa e Lirë" se policia vetëm gjatë kësaj fundjave do t'i paralajmërojë vozitësit që nuk kanë marrë patentëshoferi të Kosovës. Ndërkaq, nga e hëna, më 26 gusht policia do të nisë shqiptimin e gjobave.

Prandaj, nëse dikush prezanton patentë shoferin e lëshuar nga Serbia për qytetet e Kosovës gjatë një kontrolli të trafikut nga java e ardhshme, do të konsiderohet se nuk ka fare patentë shofer.

Gjobat për mospasje të patentë shoferëve të lëshuar nga Kosova variojnë nga 500 deri në 1 500 euro.

Afati për konvertimin e patentë shoferëve të Serbisë ishte zgjatur sërish më 8 gusht, pasi sipas Ministrisë së Brendshme të Kosovës, kishte interesim të madh të qytetarëve.

Deri më 22 gusht, 6. 25 persona kanë konvertuar patentë shoferët e lëshuar nga Serbia me ato të Kosovës, kryesisht në katër komuna me shumicë serbe në veri: Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Autoritetet e Kosovës nuk i njohin dokumentet e lëshuara nga Serbia për qytetet e Kosovës. Megjithatë, në disa raste ato "tolerohen" për shkak se procesi i integrimit të serbëve në sistemin e Kosovës nuk



ka përfunduar plotësisht.

Për këtë, sipas Elshanit, në periudhën në vijim ngasja e veturës me targa të qyteteve të Serbisë do të tolerohet me autorizim, por me patentë shofer të Kosovës.

Autorizimet për automjetet në Serbi lëshohen në bazë të letërnjoftimit dhe patentë shoferit. Praktikisht, kjo nënkupton se serbët nga Kosova, të cilët nuk e kanë ndërruar vendbanimin në sistemin serb dhe ngasin veturë me targa të një qyteti në Serbi, janë të autorizuar të kenë të dhënat e letërnjoftimit të lëshuar nga autoritetet serbe për qytetet në Kosovën të cilën Prishtina zyrtare nuk e njeh. "E dimë se ky është problem, po kërkojmë zgjidhje sepse disa njerëz e kanë problem të pajisjen me letërnjoftimin e Kosovës edhe pse jetojnë në Kosovë", ka thënë Elshani.

Konvertimit të patentë shoferëve të Serbisë me ato të Kosovës i ka paraprirë procesi i riregjistrimit të automjeteve nga serbe në targa RKS (Republika e Kosovës). Çështja e riregjistrimit të automjeteve në fund të vitit 2022 ishte shkak i një sërë krizash në veri të Kosovës: largimi i serbëve nga institucionet e Kosovës, protesta, barrikada, bojkoti i zgjedhjeve. Krizat kanë kulmuar me një sulm të armatosur ndaj Policisë së Kosovës nga një grup serbësh në shtator në Zveçan.



ShBA-ja dhe vendet e tjera të Bashkimit Evropian e kanë kritikuar disa vendime dhe veprime të ndërmarra së fundi nga qeveria e Kurtit, që janë konsideruar si "të njëanshme" dhe "të pakoordinuara". Ndërsa Departamenti Amerikan i Shtetit i ka kërkuar qeverisë Kurti që të rikthehet në "angazhim konstruktiv dhe të ngushtë" me Uashingtonin, Bashkimin Evropian dhe NATO-n, teksa Uashingtoni po ashtu ka kërkuar që institucionet e Kosovës të mos e hapin për qarkullim urën mbi lumin Ibër, duke u thirrur në shqetësime të sigurisë.

Haradinaj: Takimet e shefit të CIA-s me liderët institucionalë, lajm i mirë për Kosovën

Vizitën e shefit të CIA-s, William Burns në Kosovë e ka komentuar ish-kryeministri dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. Haradinaj ka vlerësuar takimi i zyrtarit të lart amerikan me liderët institucionalë të Kosovës është lajm i mirë.

Në këtë drejtim, ai ka thënë institucionet e Kosovës duhet të qëndrojnë të palëkundura për aleancën me Amerikën. "Të nderuar qytetarë të Kosovës, vizita e drejtorit të Agjencisë Qendrore të Inteligjencës z. Burns në Kosovë, është nder i madh për Kosovën dhe lajm i mirë për sigurinë tonë. Për ne, është jetike integrimi në familjen euroatlantike, dhe aleanca me Amerikën është e përjetshme. Institucionet e Kosovës duhet të qëndrojnë të palëkundura për aleancën me Amerikën. Takimet e drejtorit z. Burns me udhëheqësit e institucioneve, janë lajm i mirë për Kosovën. Sa i përket Kurtit dhe agjendës së tij, ia lëmë kohës ta dëshmojë, por askush nuk mund ta rrezikojë aleancën e Kosovës me Amerikën. Ajo është e përjetshme dhe jetike", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Hoti: Osmani dhe Kurti e kanë kthyer Kosovën në një çështje të sigurisë për aleatët

Ish-kryeministri i Kosovës dhe deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka reaguar ndaj vizitës së shefi të CIA-s, William Burns, në Kosovë.

Ai ka kritikuar presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti për përplasje me aleatët.

Me veprimet e tyre, sipas Hotit, Osmani dhe Kurti e kanë kthyer Kosovën në një çështje të sigurisë për aleatët. "Nga shpallja e pavarësisë, kemi punuar shumë qeveri pas qeverie për ta hequr Kosovën nga lista e vendeve me probleme të sigurisë. Në bashkëpunim të ngushtë me aleatët, janë marrë vendime të vështira dhe jopopullore, por që e përafronin Kosovën me perëndimin. Merrnim njohje të reja, anëtarësoheshim në mekanizma ndërkombëtarë, bëheshim pjesë e iniciativave rajonale e ndërkombëtare, duke e betonuar hap pas hapi të ardhmen euro-atlantike të Kosovës. Stabiliteti politik, integrimi i brendshëm i komuniteteve, normalizimi i marrëdhënieve rajonale e veprime të tjera i siguronin Kosovës zhvillim ekonomik e progres në rrugën e integrimit euro-atlantik. Rrjedhimisht, arritëm që Kosovës ta hiqnim nga lista e vendeve me probleme të sigurisë dhe ta vendosim në listën e vendeve me sfida për zhvillim ekonomik e për anëtarësim në BE dhe NATO. Jam i bindur se kjo ka qenë politika më e mençur për integrimin euro-atlantik të Kosovës", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Ai ka thënë se shefi i CIA-s do të duhej të zbarkonte në Serbi e Bosnje, dhe jo në Kosovë.

Sipas Hotit, Osmani dhe Kurti me veprimet e tyre e detyruan drejtorin e CIA-s të zbarkonte në Kosovë. "Për fat të keq të popullit të Kosovës, dogmat politike të Kurtit e Osmanit dhe konfrontimi i tyre me aleatët-garantuesit e sovranitetit të Kosovës për rendin e veprimeve në veri e kthyen Kosovën në çështje të sigurisë për NATO-n dhe BE-në, si dhe për aleatin kryesor të Kosovës, ShBA-në. Sigurisht se këtë situatë e përdori Serbia me tendencë për të krijuar një vatër të re krize në Evropë, siç dëshmohet me sulmin terrorist të 25 shtatorit 2023. Rrjedhimisht, shefi i CIA-s detyrohet të zbarkojë në Prishtinë. Ai do të duhej të zbarkonte në Bosnjë dhe Serbi, por jo në Kosovë. Kosova do të duhej të kryente të gjitha koordinimet me SHBA-në siç ka vepruar gjithmonë, përmes ambasadorit në Prishtinë, me Departamentin e Shtetit e me Shtëpinë e Bardhë", ka shkruar Hoti.

Largimi i Emmersonit, Mahmuti: Goditja më e rëndë ndaj luftës çlirimtare

Prishtinë, 23 gusht - Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues i lartë i UÇK-së, ka reaguar në lidhje me largimin e avokatit të Kadri Veselit në Gjykatën Speciale, Ben Emmerson.

Duke komentuar arsyet e përfolura për largimin e Emmersonit, Mahmuti ka shkruar në "Facebook" se kjo është goditja më e rëndë që i është dhënë mbrojtjes së luftës çlirimtare të Kosovës. "Vazhdojnë goditjet me thika në shpinë të UÇK-së! Veprimet që detyruan avokatin me famë botërore, Ben Emmerson, të largohet nga procesi i sajuar gjyqësor kundër UÇK-së në Hagë është goditja më e rëndë që i është dhënë mbrojtjes së luftës çlirimtare të Kosovës! Ne heshtim ndërkohë që argatët e Serbisë bëjnë punën e vet!", ka shkruar Mahmuti.

MSh-ja: Spitali i ri i Ferizajt do të bëhet cilësor dhe i sigurt

Prishtinë, 23 gusht - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka dalë me një sqarim lidhur me ndërtimin e Spitalit të ri të Ferizajt. Nga ky dikaster ka thënë se ky spital i ri do të bëhet cilësor dhe i sigurt.

Nga MSh-ja kanë kërkuar nga qytetarët që të kenë durim për këtë investim në shëndetësinë publike. "Kërkojmë mirëkuptimin e qytetarëve të rajonit të Ferizajt të cilët e presin me padurim këtë investim në shëndetësinë publike. Dhe i sigurojmë të gjithë se jemi në rrugën e duhur dhe ky projekt tanimë është bërë i pakthyeshëm edhe për nga koha e përfundimit edhe për nga siguria e cilësia. Prokurorisë dhe organeve të hetimit ju bëjmë sërish thirrje që të ndjekin keqbërësit për këtë dëm të madh që na kanë shkaktuar në shëndetësinë publike. Të dhënat për rastin i kanë ndërsa jemi të hapur nëse ju duhet bashkëpunim", ka njoftuar MSh-ja.

Haradinaj: Smajl Latifi, shembull i kryetarit të mirë

Rahovec, 23 gusht (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka vizituar të premten Komunën e Rahovecit ku ka takuar kryetarin e kësaj komune, Smajl Latifi.

Haradinaj ka thënë se udhëheqja e Smajl Latifit ka renditur Rahovecin në majën e komunave të suksesshme. "Komuna e Rahovecit me kryetar Smajl Latifin, sot është renditur në majen e komunave të suksesshme. Vet Smajli, model i një kryetari të mirë e me performancë të shkëlqyer, e ka renditur komunën që e udhëheq, të paren për sa i përket transparencës dhe llogaridhënies. Rahoveci i verës dhe i rrushit, është shndërruar edhe në një atraksion turistik, në qytet të festivaleve e aktiviteteve kulturore, duke arritur që njëri prej tyre, 'Hardhfesti' që mbahet në çdo fillim shtatori, të bëhet ndër më të rëndësishmit në nivel Kosove", ka thënë Haradinaj.

Haradinaj ka shtuar se Rahoveci ka sfida për shkak të obstruksioneve nga qeveria qendrore. "Në fillim të vizitës sime në Rahovec, nga kryetari Latifi dhe ekipi i tij i mrekullueshëm, u informova për projektet zhvillimore në komunë, si dhe për sfidat aspak të lehta, me të cilat po përballen ata, kryesisht për shkak të obstruksioneve nga qeveria qendrore. Me Smajlin kemi rrugëtuar bashkë, edhe në të gjitha fazat e lirisë dhe shtetndërtimit, edhe në kohë të vështira. Smajl Latifi do të jetë edhe njëri prej kandidatëve më të vlerësuar për deputet në listën e Aleancës, në zgjedhjet e përgjithshme të 9 shkurtit", është shprehur Haradinaj.

Prokuroria e shtetit ndalon 23 persona

Prishtinë, 23 gusht - Prokurori i shtetit ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit, me urdhër të prokurorit të shtetit janë ndaluar 23 persona dhe janë paraqitur tri kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj pesë personave.

Nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, gjatë 24 orëve të fundit, me urdhër të prokurorit ka ndaluar tetëmbëdhjetë persona, të dyshuar në kryerjen e veprave penale.

Prokuroria Themelore në Prizren, gjatë 24 orëve të fundit, me urdhër të prokurorit ka ndaluar për 48 orë, dy persona të dyshuar, në dy raste të ndara.

Prokuroria Themelore në Pejë, gjatë 24 orëve të fundit ka ndaluar një person dhe ka paraqitur një kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit kundër një personi.

Prokuroria Themelore në Gjilan, me urdhër të prokurorit ka ndaluar një person, në kohëzgjatje prej 48 orëve dhe ka parashtruar një kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit kundër dy personave.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, gjatë 24 orëve të fundit ka ndaluar një person, si dhe ka paraqitur një kërkesë për caktimin e paraburgimit për dy persona.

Parandalohet kontrabandimi i mallrave nga Serbia

Prishtinë, 23 gusht - Dogana dhe Policia e Kosovës kanë parandaluar kontrabadmin e mallrave të ndryshme ushqimore në vlerë 2 000 euro. Sipas njoftimit të doganës, një automjet është identifikuar duke hyrë nga Serbia në Kosovë dhe është arritur të ndalet ku është gjetur malli.

"Në brezin kufitar që lidh fshatin Breznicë - SRB me fshatin Karaqevë e Poshtme - RKS nga njësitet e lartcekura është identifikuar automjeti transportues me targa vendore i cili vinte ilegalisht nga Serbia. Pas përcjelljes nga njësitet e lartcekura është arritur të ndalet. Gjatë kontrollit të automjetit, i cili drejtohej nga shtetas kosovar është vërejtur se kishte të ngarkuar mallra të ndryshme ushqimore me vlerë rreth 2 000 euro. Mallrat dhe automjetit janë sekuestruar dhe dërguar në terminalin doganorë Dheu i Bardhë. Rasti është duke u trajtuar nga njësitet relevante të Doganës së Kosovës", ka njoftuar dogana.

Hovenieri: I frymëzuar nga talenti i jashtëzakonshëm në Kosovë

MITROVICË, 23 GUSHT - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeff Hovenier, ka njoftuar se të enjten mbrëma ka qenë në Mitrovicë dhe se për të ishte kënaqësi të merrte pjesë në festivalin "Mitrovica International Jazz Days (MIJD)".

Me anë të një postimi në platformën "X", ai ka thënë se është i frymëzuar në vazhdimësi nga talenti i jashtëzakonshëm në Kosovë dhe nga mënyra se si muzika mund t'i bashkojë njerëzit. "Ishte një gëzim për të marrë pjesë në MIJD festival dje në mbrëmje. I frymëzuar vazhdimisht nga talenti i jashtëzakonshëm dhe mënyra se si muzika mund t'i bashkojë njerëzit. Diplomaci kulturore", ka shkruar Hovenieri.

Përveç Hovenierit, në mesin e të ftuarve që kanë shijuar muzikë xhez ishin edhe figura të tjera të rëndësishme të vendit.

Kurti dhe Dibrani diskutojnë për programet rehabilituese në burgjet e Kosovës

PRISHTINË, 23 GUSHT (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar të premten objektin qendror të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) në Prishtinë, ku është pritur nga drejtori Ismail Dibrani. Në këtë vizitë ai shoqërohej nga ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu dhe Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla.

Në qëndrimin atje është biseduar mbi punën dhe sfidat e shërbimit korrektues, teksa në 11 burgjet e Kosovës ndodhen gjithsej 1 734 të burgosur, prej tyre 1 120 të dënuar. Është theksuar se me miratimin e Ligjit për ShKK-në me të cilin janë themeluar njësi të reja, si ato për vlerësimin dhe klasifikimin e të burgosurve, për inteligjencë, njësia ekonomike dhe themelimi i institucionit për trajtimin e personave me nevoja të veçanta, si dhe miratimi i planit zhvillimor strategjik për ShKK-në 2023-2027, synohet përmbushja e vizionit të agjencisë.

Gjithashtu është biseduar edhe për programet rehabilituese dhe aftësimin profesional për të dënuarit dhe mundësitë e bashkëpunimit me organizata të ndryshme.

Me qëllim përmirësimin e infrastrukturës, me përkrahjen e qeverisë është ndarë buxheti prej 8 milionë euro për ndërtimin e qendrave të reja korrektuese, e ato janë: Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan; Qendra e Paraburgimit në rajonin e Prizrenit me kapacitet prej 300 shtretër dhe zgjerimi i Institutit të Psikiatrisë Forenzike.

Revista e njohur "Travel+Leisure" thotë se plazhi më blu në botë gjendet në Shqipëri

Tiranë, 23 gusht - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka shpërndarë një artikull të revistës së njohur "Travel+Leisure", e cila ka shkruar se plazhi më blu në botë gjendet në Shqipëri.

Bëhet fjalë për plazhin "Pasqyra" në jugun e Shqipërisë. "Kërkimet treguan se plazhi me ujin më blu në botë gjendet në Evropë dhe përkatësisht në Shqipëri. Revista e njohur 'Travel+Leisure', rrëfen se për të ndihmuar njerëzit të gjejnë ujin më blu, grupi 'CV Villas' analizoi rreth 200 plazhe përreth botës, duke përdorur kodin RGB të ngjyrës dhe duke e kryqëzuar atë me kodin 'YInMn Blue' ose bluja më e thellë që ekziston, e cila u zbulua në vitin 2009, nga shkencëtarët e Oregon State University në ShBA. Hulumtimi nxori se 'Plazhi Pasqyra' në jugun e Shqipërisë është plazhi me ujin më blu në botë revista thotë se 'Plazhi Pasqyra' është vetëm 12.4 pikë (ose gradacione) larg nuancës ;YInMn Blue;, çka e vendos atë të parin në listë, ndjekur nga 'Plazhi i Gjatë' (Paralia Mpouka) në Greqi, në vendin e dytë me 13.6 pikë larg 'YInMn Blue', e pastaj Kassiopi po në Greqi në vendin e tretë dhe 'Plage de la Vernette' në Francë e 'Plazhi Kaputaş' në Turqi përmbyllin pesëshen e më të mirëve 'Morali i kësaj historie', përfundon revista, 'është se nëse dëshironi të shihni disa ujëra vërtet të kaltër, rezervoni sa më parë një fluturim për në Shqipëri dhe në Greqi'", ka shkruar Rama në rrjetet sociale.

22 kandidatë fillojnë rrugëtimin e tyre për t'u bërë kadetë të FSK-së

Prishtinë, 23 gusht - Në kazermën "Adem Jashari", 22 kandidatët e përzgjedhur kanë filluar rrugëtimin e tyre ushtarak për t'u bërë kadetë të Qendrës për Studime Universitare pranë Akademisë Ushtarake të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Në njoftimin e FSK-së është thënë se gjatë kësaj jave kandidatët do të testohen në disiplina të ndryshme ushtarake për të parë edhe një herë gatishmërinë dhe përgatitjen e tyre fizike për t'u bërë kadetë të ushtrisë kosovare.

Forca e Sigurisë së Kosovës çdo vit shkollon gjenerata të reja të kadetëve të cilët pas katër vitesh studimi ushtarak në QSU dhe RIT, bëhen oficerë të FSK-së.

ASK-ja: Më shumë thëngjill të prodhuar në qershor 2024 sesa vitin e kaluar

Prishtinë, 23 gusht - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e energjisë" për muajin qershor 2024 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë.

ASK-ja ka njoftuar se ka më shumë thëngjill të prodhuar në qershor 2024 sesa në muajin e njëjtë të vitit paraprak. "Gjatë muajit qershor të vitit 2024, energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 465.32 GWh, kurse konsumi i energjisë elektrike ishte 343.46 GWh ose 0.8 për qind më i madh me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 10.81për qind. Sipas ASK-së, importi i energjisë elektrike në qershor 2024 ishte 145.55 GWh, kurse eksporti i energjisë elektrike në të njëjtën periudhë ishte 263.88 GËh (këtu janë të përfshira edhe sasia e transmisionit). Prodhimi i thëngjillit ishte rreth 620.90 mijë ton ose 27.07 për qind më shumë sesa në muajin e njëjtë të vitit paraprak", ka njoftuar ASK-ja

Sot nën Albin Kurtin po vuajnë më së shumti minatorët dhe punëtorët

Nga Besa ISMAILI

Veprimet e këtij kryeministri hipokrit vërtetë s'kanë të ndalur. Ai dhe turma e tij politike pretendojnë se mbështesin klasën punëtore dhe mbrojnë drejtësinë sociale, por nuk arrijnë të kujdesen dot për minatorët dhe punëtorët që varen nga pagat e tyre për të siguruar jetesën.

Duke marrë pjesë në një konventë të partisë së majtë në ShBA (Demokratët) dhe duke predikuar dhe aktruar idealet progresiste duke lënë pas dore nevojat e minatorëve, ky kryeministër tregon haptas mungesën e integritetit dhe përkushtimit ndaj këtyre parimeve.

Hipokrizia e Albin Kurtit është tradhti ndaj atyre që vuajnë nën udhëheqjen e tyre dhe për këtë ai duhet të mbajë përgjegjësi.

Sot, nën udhëheqjen e Albin Kurtit, vuajnë të gjithë, por askush më shumë sesa minatorët dhe punëtorët.

Në mbledhjen e qeverisë kur deklaron se ka më shumë punëtorë mbi tokë sesa xehe nën tokë, kryeministri dëmtues z. Kurti, publikisht kërcënon për mbyllje të vendeve të punës për këta minatorë, dhe mbylljen e Trepçës.

Përndjekja tashmë ka filluar. Ndalja e pagave, kushtet mizërie dhe mashtrimi me katër-milionëshin janë vetëm hyrje në kapitullin e mbylljes së minierave dhe lënies në rrugë të minatorëve.

LDK-ja: Nagip Krasniqi dhe Martin Berishaj kanë qenë në krye të mafisë energjetike

Prishtinë, 23 gusht - Anëtari i Kryesisë së LDK-së, Visar Azemi, në një konferencë për medie ka folur për aktakuzën ndaj ish-drejtorit të KEK-ut, Nagip Krasniqit dhe ambasadorin e Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj.

Ai ka thënë se vetë instalimi i Krasniqit në krye të KEK-ut ka qenë problematik. Mirëpo, sipas tij, fatkeqësia më e madhe qëndron se edhe pas arrestimit të tij, "i madh e i vogël nga partia në pushtet e nga qeveria, i dolën në mbrojte atij duke u përpjekur ta shfajësonin".

Ai ka theksuar se ndërprerja e bllokut A5 Termocentralin Kosova A i ka kushtuar Kosovës rreth një milionë euro në ditë, të cilën e sipas tij e ka ndërmjetësuar njeriu tjetër i pushtetit, ambasadori i Kosovës në Kroaci dhe "kryemafiozi i energjisë", Martin Berishaj".

"Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës këtë javë ngriti aktakuzë ndaj ish-drejtorit të KEK-ut, Nagip Krasniqit, i cili u arrestua me 19 prill 2023. Siç e thotë aktakuza, ky njeri nga 15 tetori i vitit 2021 e deri më 19 prill 2023, kur edhe u arrestua, në cilësinë e personit zyrtar, ka kryer veprën penale 'Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar'. Duhet ta themi se vetë instalimi i tij në krye të KEK-ut ka qenë problematik. Sepse këtë person aty e solli partia në pushtet, pasi dhe ai ishte drejtues i Komitetit për Energji në Lëvizjen Vetëvendosje. Dhe ai erdhi në këtë pozitë nga bordi i përkohshëm, të cilin e kishte emëruar qeveria Kurti", ka thënë Azemi, duke dhënë statistika se sa ka paguar Kosova rrymë brenda një dite.

"Derisa kjo ishte e keqja e parë, fatkeqësia tjetër është se edhe pas arrestimit të Nagip Krasniqit, i madh e i vogël nga partia në pushtet e nga qeveria, i dolën në mbrojte atij duke u përpjekur ta shfajësonin. E mbronin dhe e mbrojnë ani pse e dinin se ky person dyshohej e akuzohej për negocimin e një tenderi sekret në vlerë prej 3.4 milionë eurove. Krejt kjo kur blloku A5 në Termocentralin Kosova A ishte ndërprerë, e në mënyrë të pakuptimtë shtyhej remonti i këtij blloku. E kjo i kushtonte Kosovës rreth 1 milionë euro në ditë duke blerë rrymë, të cilën e ndërmjetësonte njeriu tjetër i pushtetit, ambasadori i Kosovës në Kroaci dhe kryemafiozi i energjisë, Martin Berishaj", ka thënë Azemi.

Eksportet bujqësore në Shqipëri shënojnë rritje për 25 për qind në muajin korrik

Tiranë, 23 gusht - Eksportet bujqësore kanë vazhduar trendin rritës edhe gjatë muajit korrik në Shqipëri. Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, ka bërë me dije se "në muajin korrik u shënuan 58 113 tonë eksporte me vlerë 4.5 miliardë lekë dhe një rritje prej 25 për qind krahasuar me një vit më parë. Në korrikun e vitit të kaluar u shënuan 46 468 tonë eksporte. Prodhimet shqiptare po zgjerohen gjithnjë e më shumë në tregjet e huaja, duke pasqyruar rritjen në cilësi dhe fuqizimin e fermerëve në vend", ka thënë Denaj.

Ekspozimi i Shqipërisë si destinacion turistik dhe politikat mbështetëse për fermerët, kanë rritur vlerën e prodhimit bujqësor në tregjet e huaja.

Produktet kryesore bujqësore që eksporton Shqipëria janë bimët mjekësore, perimet e freskëta dhe të përpunuara, vaji i ullirit, vajrat esenciale, shalqinj, fruta, peshk të konservuar, etj.

George F. KENAN: Memoare 1925-1950 (7)

Klasa sunduese ruse respekton vetëm të fortit!

“Të mos bëjmë gjeste të kota të vullnetit të mirë”

Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ

Pak kush nga ne ka parafytyrime se çfarë huti dhe dyshime kanë nxitur në vetëdijen sovjetike amerikanët qëllimmirë me gjestet e tyre dhe me veprimet me të cilat janë përpjekur, kanë synuar që ti bindin rusët për ndjenjat e tyre miqësore. Veprimet e tilla rusëve ju çrregullojnë të gjitha llogarit, parashikimet dhe ata i qesin nga ekuilibrimi. Ata menjëherë mendojnë se i kanë mbiçmuar forcat tona, se i kanë nënçmuar detyrat e tyre ndaj shtetit sovjetik, se gjithë kohën janë detyruar që prej neve të kërkojnë më tepër. Prandaj, në këtë mënyrë, pikërisht shpesh arrijmë efekt të kundërt nga ai të cilin e dëshirojmë.

D. Të mos kërkojmë prej asgjë prej rusëve nëse nuk jemi të gatshëm që, në rast të refuzimit të tyre, tu mundësojmë të ndjejnë, hetojnë pakënaqësinë e tyre në mënyrë praktike.

Parimisht do të ishte dashur që të ishim gati që secili manifestim të dëshirave tona ta përcjellim me ndonjë aksion i cili rusëve do të tregonte, bënte me dije se interesat e tyre nuk do të përfillen nëse ata nuk i respektojnë dëshirat tona. Për këtë, është e nevojshme imagjinata, forca dhe politika efektive. Nëse në punët tona të jashtme nuk mund ti gjejmë ato veçori, atëherë më së miri është që të bëhemi gati në situata, seriozisht të pakëndshme.

E. Ti shqyrtojmë çështjet në nivelin normal dhe të kërkojmë prej rusëve që në atë nivel të pranojmë, marrin përgjegjësit e plota për veprimet e tyre.

Parimisht, kërkesat nuk do të ishte dashur që t’i paraqesim instancave të larta, vetëm për shkak se nuk na janë përfillur në instancat më të ulëta. Kjo vetëm e nxit burokracinë ruse që të jetë sa më refuzuese, kurse marrëdhëniet tona me nivelet më të larta sovjetike i ngarkon me çështjet dytësore për nga rëndësia. Në vend të kësaj, ne duhet që të gatshëm dhe pa hezitim, vonesë të ndërmarrim hapat e hakmarrjes ose të korrektimit, përmirësimit, pra posa të na është refuzuar kërkesa në instancat më të ulëta. Vetëm në këtë mënyrë mund ti mësojmë rusët që të respektojnë hierarkinë e tërësishme të funksionarëve tanë të cilët duhet të bashkëpunojnë me ta. Nëse ne nuk i përkrahim funksionarët tanë në punën e tyre me rusët, atëherë ne vet e vështirësojmë arritjen e qëllimeve tona. Kjo u shërben interesave ruse kurse i dëmton interesat tona. Fjala është për një çështje shumë të rëndësishme, për çështjen e cila është në fund të shumë mossukseseve tona në dy ose tri vitet e fundit. Ne duhet ti mësojmë rusët se i tërë aparati i tyre, dhe jo vetëm Stalini, duhet të reagojnë në mënyrë të arsyeshme ndaj kërkesave tona.

Rusët nuk ngurojnë për skandale dhe skena

F. Të mos fillojmë, iniciojmë me rusët këmbimin e mendimeve në nivelet e larta nëse së paku iniciativa 50 për qind të mos vijë prej tyre.

M rusët mund të bashkëpunojmë me sukses vetëm atëherë kur ata vet diçka kërkojnë, dhe kur ndjenë në pozitë varësie. Do të ishte dashur që të aprovonim rregullën që me ta të negociojmë në nivele të larta vetëm kur ekzistojnë kushtet për këtë.

G. Mos të frikohemi përdorimit të armatimit të rëndë për atë që na duket më pak e rëndësishme.

Kjo, po ashtu është çështje shumë e rëndësishme, mirëpo edhe çështje të cilën shumë amerikanë do ta marrin me dyshim. Ata gjithmonë synojnë që secilën çështje ta ashpërsojnë deri në atë pikë e cila sipas mendimit të tyre është pikë kthesë në durimin e atyre me të cilët kanë punë. Nëse e dinë se kundërshtari mendon seriozisht, ata atëherë do të jenë të kujdesshëm dhe të arsyeshëm. Ata nuk dëshirojnë ballafaqim nëse me ata që kanë forcë superiore. Mirëpo, pavendosmërinë ose tolerancën qëllimmirë ata e hetojnë shumë shpejt dhe e shfrytëzojnë. Prandaj, kushdoqoftë që ka punë me ta duhet të përpiqet që në secilën kohë të mbaj vendosmërinë dhe kujdesin në mbrojtjen e interesit të vet.

Të mos u frikohemi situatave të pakëndshme dhe paraqitjes publike të mospajtimeve.

Rusët nuk ngurrojnë për skandale dhe skena. Nëse zbulojnë se dikush tjetër ngurron, u frikohet atyre dhe bëjnë çdo gjë që të evitojnë përplasjet, atëherë ata do të shërbehen me atë fakt duke e përdorur si shenjë, akt kërcënimi duke menduar se do të kenë përfitime. Nëse duam ta rikthejmë autoritetin tonë te pushteti rus dhe të fitojmë respekt në Rusi, atëherë duhet të jemi të gatshëm të ndërmarrim veprime që mund të nxisin pakënaqësi. Nga ana tjetër, nuk duhet të frikohemi se herë pas herë fjalët e të rënda, gjithnjë do të veprojnë në marrëdhëniet tona. Rusi është më dashamirës, i kujdesshëm, kur të merr të ramën nëpër gishtërinj. Ai i përshtatet shumë lehtë luftës së ashpër dhe rrallëherë bën vërejtje për këtë. Të mos e harrojmë reakcionine parë të Stalinit kur ishte takuar me Ribentropin. Ai i ishte përkulur me cinizëm luftës së ashpër propaganduese e cila me vite ishte zhvilluar ndërmjet dy shteteve. Klasa sunduese ruse respekton vetëm të fortët. Për të evitimi i konfliktit, mosmarrëveshjes, fjalosjes, zënkës është vetëm formë e dobësisë.

Roli i Ambasadës amerikane në Moskë

I. Në pajtim me politikën e vet të përcaktuar, të koordinojmë të gjithë veprimtarinë në lidhje me Rusinë dhe të gjithë atë veprimtarinë, private amerikane të njëjtit karakter në të cilin administrata mund të ndikojë.

Rusët janë të shkathtë që t’i shfrytëzojnë konfliktet, pavendosmërinë dhe luftën për qëllime private të bashkëqytetarët tanë ose të organet shtetërore. Sistemi i tyre është asisoj i ndërtuar që ju siguron koncentrimin maksimal të energjive nacionale. Ne nuk mund tu kundërvihemi me sukses nëse nuk ndërmarrim gjithçka që mund të koncentrojmë përpjekjet tona. J. Ta forcojmë dhe ta përkrahim përfaqësinë tonë në Rusi.

Ambasada amerikane në Moskë për rusët është simbol i vendit tonë. Shumë njerëz me kujdes e përcjellin punën e saj. Ajo duhet të jetë jo vetëm përfaqësi e vendit tonë, por edhe qendër udhëheqëse e politikës sonë ndaj Rusisë. Edhe përkundër asaj se shpesh e nënçmojnë dhe nuk e përkrahin, ajo megjithatë ka arritur të bëhet institucion pionier në shërbimin e jashtëm politik amerikan de misioni më i respektuar diplomatik në Moskë. Nëse do t’i jepej përkrahje konkrete, ajo do të mund të bënte më shumë dhe të luante një rol edhe më të madh në Bashkimin Sovjetik. Kjo do të thotë se mangësitë, lëshimet e qeverisë sovjetike që ti siguroj objektet, institucionet dhe kushtet thera për kryerjen e punëve diplomatikë në Moskë, duhet sa më parë ose më vonë ti paraqesim në mënyrë të hapur si çështje të pazgjidhur midis dy qeverive dhe duhet bërë presion në mënyrë që ato kushte të përmirësohen. Kjo do të thotë se, në krye të përfaqësisë gjithmonë duhet të jetë dikush i aftë dhe i gatshëm për punë të vështir për një kohë më të gjatë, i cili është i frymëzuar vetëm me përkushtimin e interesave të vendit tonë, dhe i cili posedon me aso personaliteti dhe të kaluar që të mund të fitoj respektin e një populli me të cilin, në analizën psikologjike të personalitetit të njeriut, nuk mund të shtyhet asnjë popull tjetër. Sinqerisht besoj se në rastin e ambasadorit Harriman këto kushte plotësohen. Mirëpo, këtë vërejtje po e shtroj vetëm duke shikuar me një sy në të ardhmen. Përfaqësia në Moskë punon dhe gjithmonë ka punuar me përpjekjet e mëdha, e ballafaquar me shumë vështirësi. Ambasadori mendjelehtë, i pa vendosur dhe i paditur mund t’i thyejë vetit qafën dhe t’i shkaktojë dëme marrëdhënieve amerikano – ruse. (Fund)

Furtuna, fundosje dhe spiunazh kibernetik: “Menyja” e komplotit është gati

Një jaht luksoz, Bayesian që u mbyt më 19 gusht disa qindra metra larg portit të Palermos. Deri këtu, nuk do të kishte asgjë të jashtëzakonshme. Gjërat ndryshojnë sapo mësohet identiteti i personave në bord dhe, për fat të keq, viktimave. Ndër këta, më famshmi është padyshim manjati britanik Mike Lynch.

Një aksident rrugor në Angli, në rajonin e Cambridgeshire: një këmbësor u godit me makinë më 17 gusht dhe vdiq dy ditë më vonë. Sërish, asgjë e jashtëzakonshme, nëse nuk do të ishte për identitetin e viktimës: Stephen Chamberlain, partneri i Lynch.

Ajo që bashkon dy tragjedi të largëta gjeografikisht dhe ngjyros me të verdhë të gjithë historisë është marrëdhënia që lidhte dy viktimat: Lynch dhe Chamberlain ishin partnerë biznesi. Së bashku ata kishin themeluar dy kompani: Darktrace dhe Autonomy. Realitete aktive në botën e sigurisë kibernetike, më konkretisht spiunazhit kibernetik. Dhe menyja e komplotit “u shërbye”. Që në orët e para të 20 gushtit, kur filloi të përhapej lajmi për mbytjen e anijes, nisën akuzat: nuk mund të jetë rastësi që menjëherë pasi u lirua nga akuza për mashtrim (për shitjen e Autonomy) Lynch vdiq. Praktikisht në të njëjtën kohë me partnerin e tij Chamberlain. Në Palermo u zhduk edhe avokati i Lynch, Chris Morvillo.

U fol për trafiqe të errëta të viktimave të dy aksidenteve. Të cilët, megjithatë, sapo vinin nga një fitore gjyqësore: “Pesëmbëdhjetë të mbijetuarit e anijes Bayesian, përfshirë Angela Bacares, gruan e Lynch, konfirmuan se festa me varkë ishte organizuar për të festuar lirimin e plotë të Lynch dhe Chamberlain, të cilët në qershor u liruan të dy nga akuzat për mashtrim dhe llogari të rreme nga gjykata e San Franciskos”.

Në të vërtetë, diku shkruhej madje se ndonjë shërbim sekret i pamundura mund ta ketë goditur Bayesianin me një vorbull të targetuar. E parashikueshme, ndoshta edhe e natyrshme. Kur ka marrëdhënie me shërbimet sekrete (Darktrace është një mjet jashtëzakonisht i avancuar që përdor një sistem të inteligjencës artificiale i cili mëson vetë), porosi miliarda dollarëshe me Pentagonin, marrëveshje me CIA dhe NSA, një aksident rrugor dhe një mbytje anije, të zhytesh në teoritë e konspiracionit është mënyra më e thjeshtë, është ajo që jep përgjigjet më të menjëhershme. Sepse ato, teoritë e komplotit pra, ofrojnë rregull aty ku ka veç ngatërresa. Dhe kaos.

Megjithatë, ka një gjë që duhet marrë parasysh: rasti ekziston. Dhe ne duhet të merremi me të. Le të supozojmë gjithashtu, që një aksident rrugor si ai në të cilin mbeti viktimë Chamberlain, mund të organizohet me lehtësi relative. Por e njëjta gjë nuk mund të thuhet për mbytjen e një anijeje që përfshin 22 persona, e cila gjithashtu ndodhi gjatë një stuhie. Shkaku i të cilës duket se lidhet, siç kujton klimatologu Paolo Sottocorona, me gjendjen problematike në të cilën ndodhet Deti Mesdhe, i tropikalizuar gjithnjë e më shumë për shkak të ngrohjes globale: “Deti i ngrohtë duket i këndshëm, por nxehtësia nga pikëpamja fizike është energji. Mesdheu për momentin është një depozitë benzine. Po të vendosësh një shkrepëse aty, pra një rrymë ajri të ftohtë si ato të këtyre ditëve, shpërthen”, thoshte Sottocorona për La Repubblica.

Sigurisht, sapo u shfaqën marrëdhëniet e Lynch me shërbimet e fshehta, kujtesa kolektive u zhvendos në mënyrë të pashmangshme tek një tjetër anije të mbytur: ajo e 28 majit 2023, kur në liqenin Maggiore u fundos një varkë plot me agjentë Aise dhe Mossad, së bashku me të gjitha sekretet e atij takimi të pazakontë. Edhe në atë rast një vorbull, apo në çdo rast një përkeqësim i papritur i kushteve atmosferike.

Edhe nëse shumë rastësi mund të duken befasuese apo edhe shqetësuese, është gjithmonë mirë që të analizohen faktet në bazë të elementeve që kemi në dispozicion: ekziston një video e qartë e momentit të fundosjes së Bayesian-it, i “gëlltitur” nga dallgët në më pak se një minutë, ku nuk duket se shfaqen elementë të palëve të treta, që sugjerojnë sabotim; duhet analizuar mundësia që zona të tilla si porti i Palermos, qyteti i pestë italian për nga popullsia, mund të jenë shkelur nga ata që me sa duket donin të ndërhynin ose të organizonin një formë sabotimi ose ndërhyrjeje të jashtme. Dikush mund të pyesë veten nëse ata që donin të mbyllnin gojën e Lynch-it për të zgjidhur sekretet e paspecifikuara ose llogaritë personale, nuk do kishin menduar për një metodë më pak të dukshme.

Së fundi, ekziston dilema e vjetër “kush përfiton?”, duke qenë se figura e viktimës më të diskutuar të mbytjes u ngrit në sytë tanë, bashkë me ngarkesën e mistereve që e rrethuan pas vdekjes së tij. Si përfundim, le ta lëmë hetimin të ecë, përpara se të hidhemi në përfundime të lehta. Nëse do të donim të kënaqeshim me një majë të teorisë konspirative, le të themi se nëse do të ishim 007, këto ditë do të shmangnim çdo ftesë për të marrë pjesë në një udhëtim me varkë. Por kjo është një histori tjetër.

Inside Over – Bota.al

Lëndimi prej padrejtësisë

Nga mosha 4 deri në 6 vjeç, kur fëmija fillon të kuptojë se është një individ me karakteristikat e veta, mund të ndodhë zgjimi i kësaj plage. Ajo shkaktohet nga prindër shumë kërkues, të cilët mund të kërkojnë më shumë sesa mund të japë ose të përballojë një fëmijë. Të mos qenit në gjendje të shprehet përjetohet me një ndjesi padrejtësie, veçanërisht ndaj prindit të të njëjtit seks. Fëmija vuan nga kritikat që merr, ashpërsia, intoleranca ndaj tij, ftohtësia dhe përshtatja me disa rregulla të sjelljes që kërkon prindi.

Për të shmangur vuajtjet, ai ndalon së perceptuari atë që ndjen, fillon të krijojë një maskë ngurtësie, duke u përpjekur të mos ndjejë atë që ndjen dhe gjithashtu të mos ua tregojë të tjerëve. Ai fillon kështu të shfaqet i ftohtë dhe i pandjeshëm, të kërkojë saktësi dhe drejtësi në çdo gjë, duke u bërë perfeksionist për t'u ndjerë "i drejtë". Që në moshë të vogël në fakt ka vënë re se vlerësohet për atë që bën më shumë se për atë që është, ndaj bëhet efikas dhe preciz, duke shfaqur pozitivitet dhe optimizëm, për të mos ndjerë vuajtje.

Të jetosh në pakënaqësi

Prandaj, emocioni që personi ndjen më shpesh është zemërimi, veçanërisht ndaj vetvetes, edhe nëse gjëja e parë që ai bën është të sulmojë dikë tjetër. Në mënyrë të pandërgjegjshme ai është i zemëruar me veten e tij, ndoshta sepse nuk i ka vlerësuar gjërat siç duhet, ose për faktin se nuk ka bërë gjënë e duhur. Duke mos e perceptuar atë që ndjen, ai e ka të vështirë ta lejojë veten të dashurohet dhe të lërë gjërat të ndodhin, por edhe të demonstrojë dhe deklarojë dashurinë e tij.

Kjo do të përcaktojë dy lloje të ndryshme të rriturish, që i bashkon megjithatë ndjenja e vazhdueshme që ata përjetojnë: pakënaqësia. Në rastin e parë, çdo gjë që ata bëjnë do të duhet të jetë e përshtatshme për të kënaqur në mënyrë të pandërgjegjshme prindërit e tyre; në të dytën ata do të perceptojnë se nuk po bëjnë kurrë aq sa duhet për t'i kënaqur ose për t'i bërë të lumtur. Vështirë se do ta kuptojnë këtë plagë, e para sepse për ta është normale (kështu janë edukuar që në vitet e para të jetës); së dyti sepse të njohësh plagën është si t'u bësh keq prindërve.

Në marrëdhënie ata presin që partneri i tyre të korrespondojë me pritshmëritë e tyre. Ata janë shumë kërkues, nisur nga përkushtimi absolut në çift. Ata gjithmonë veprojnë që të ndihen të drejtë. Për të bërë gjithçka me saktësi, do t'i duhet kohë, e cila gjithmonë do të jetë shumë pak dhe shpesh do të jetë vonë, edhe nëse nuk i pëlqen, sepse duhet të përgatiten.

Në fëmijëri e ka përjetuar si problem autoritetin, sepse është detyruar ta pranojë dhe tani e ka frikë; kur i kërkohet diçka, nga frika se mos i besohet, e përjeton atë me një ndjenjë padrejtësie.

Marrëdhëniet me të tjerët

Duke dashur gjithmonë të ketë të drejtë, ai i kushton shumë rëndësi "gjërave të merituara". Në fakt, ai përpiqet të shmangë marrjen e shpërblimit që beson se është i pamerituar, ashtu siç vërehet shpejt kur dikush, sipas tij, nuk e meriton vëmendjen apo shpërblimet që merr. Pikërisht për shkak të ndjenjës së fortë të padrejtësisë, ai shpesh tërheq në jetën e tij situata që i konsideron të padrejta, edhe brenda familjes. Vetë ngurtësia e tij do të thotë që ai gjithmonë do të bëjë më shumë se të tjerët që, përkundrazi, do të priren të lajnë duart. Vetëm shërimi i plagës do të lejojë që situata të tilla të fillojnë të pakësohen ose të zhduken nga jeta e tij. Ai duhet të mbajë gjithçka në rregull, madje mund të bëhet obsesiv në përpjekjen për të mbajtur gjithçka sipas kritereve të veta.

Gjithmonë mundohet t'i mbajë gjërat nën kontroll që të jenë "të drejta"… siç do ai. Duke i imponuar vetes shumë detyra, shpesh ngurtësia theksohet sepse të jesh perfekt në çdo gjë nuk është e lehtë. Ai ka një aftësi të madhe për të mos ndjerë dhimbje, kështu që vazhdon pafundësisht, dhe rrallë është i sëmurë dhe nëse është, e vëren vetëm kur gjendja përkeqësohet.

Maska reflektohet edhe në trup

Ngurtësia tipike e individit e bën atë të ftohtë si në ton ashtu edhe në lëvizje. Ashtu si qëndrimi, edhe trupi bëhet i ngurtë. Kjo maskë i bën ata që vuajnë prej saj, perfeksionistë të mëdhenj; Ie bën të përjetojnë zemërim, padurim, kritikë dhe intolerancë ndaj vetvetes.

Personi është shumë kërkues dhe nuk respekton kufijtë e tij. Sa herë që e mban veten nën kontroll, përmbahet ose tregohet i ashpër ndaj vetes, është shenjë se ka vendosur maskën e ngurtësisë. Prandaj, trupi bëhet i drejtë dhe jo fleksibël. Ai është gjithashtu i ngurtë në lëvizjet e tij, madje mund t'i shtrëngojë këmbët dhe t'i rreshtojë me trupin. Kur kryqëzon këmbët dhe krahët, është për të mos ndjerë se çfarë po ndodh, dhe kur shtrëngon nofullën është për të mbajtur zemërimin.

Sidoqoftë, vështrimi i tij është i gjallë dhe i ndritshëm. Ai është i padrejtë me veten sepse kritikon veten dhe e ka të vështirë të shohë cilësitë e veta pozitive dhe gjërat e mira që bën. Ai vuan sepse sheh vetëm atë që nuk është bërë, ose vetëm gabimin e bërë. Ai priret të vuajë duke pasur vështirësi për t'i dhënë vetes gjërat që i japin kënaqësi.

Konkluzione

Ne duhet të pranojmë se askush nuk është i përsosur, madje as ne vetë; nuk ka asgjë të keqe të njohësh kufijtë e tu, të kërkosh dhe të pranosh ndihmë dhe të kesh njohjen e duhur. Lëndimi nga padrejtësia fillon të shërohet pasi personi i ngurtë i lejon vetes të jetë më pak perfeksionist, të bëjë gabime, të tregojë anën e tij më të brishtë, duke qarë ose duke kërkuar ndihmë, pa e gjykuar veten ose pa patur frikë se mos gjykohet dhe pa patur frikë se do të humbasë kontrollin. / bota.al

sport



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sot përballen Llapi-Malisheva dhe Ferizaj-Prishtina

PRISHTINË, 23 GUSHT - Në këtë fundjavë do të luhet xhiroja e tretë e Superligës së Kosovës në futboll. Dy ndeshje do të luhen sot (e shtunë) e dy të tjera nesër (e diele), ndërsa një tjetër është shtyrë. Aktualisht, tabelës i prijnë katër skuadra me nga katër pikë. Kampioni në fuqi, Ballkani do të përballet me Feronikelin, kurse Llapi do të jetë mikpritës i Malishevës. Dukagjini do t'i kërkojë pikët e para sezonale teksa e pret Gjilanin, i cili tregoi lojëra të mira nga ana e tij. Kurse, Prishtina me shumë ndryshime në këtë edicion do ta vizitojë të rikthyerin në Superligë, Ferizajn, i cili befasoi për të mirë në këtë fillim-sezoni, ndërsa tash po bën përforcime të tjera. Me kërkesë të Dritës, për shkak të angazhimeve të saj në garat evropiane, ndeshja e ekipit "bardhekaltër" me Suharekën është shtyrë. Drita madje nuk e ka zhvilluar ende asnjë ndeshje në këtë sezon në Superligë për shkak se fokusin total e ka tek Liga e Konferencës, ku ka arritur deri në "play-off". Nga kjo fundjavë, ndeshjet e ligës elitare do të nisin nga ora 16:00. Sot takohen: Llapi-Malisheva dhe

Ferizaj-Prishtina, nesër takohen: Dukagjini-Gjilani dhe Ballkani-Feronikeli 74.

Kosova sërish e mposhti Malin e Zi

Prishtinë, 23 gusht - Kosova ka mposhtur Malin e Zi edhe në miqësoren e dytë me rezultat bindës, 6-0. "Dardanet" të motivuara nga fitorja e parë, dhanë maksimumin në fushë duke siguruar rezultat tejet pozitiv. Të përzgjedhurat e Sanije Krasniqit edhe në këtë ndeshje dominuan qysh nga fillimi, derisa rrjetën e portës kundërshtare arritën ta tundin në minutën e 22-të, kur shënoi Krenare Kelmendi për 1:0. Misioni i "dardaneve" nuk përfundoi me kaq, pasi të përkushtuara dhe të etura për rezultat më të thellë, shënuan sërish në minutën e 30-të kur nga gjuajtja e lirë për 2:0 realizoi Olsa Maqastena. Pesë minuta më vonë porta e kundërshtarit u pushtua sërish. Agnesa Krasniqi shënoi golin e fundit të pjesës së parë, e cila përfundoi me rezultat 3:0. Performancë të njëjtë Kosova pati edhe në pjesën e dytë. Në minutën e 69-të Loela Ahmeti realizoi golin e katërt. Goli i pestë me radhë erdhi nga penalltia ku saktësia e Bora Bajramit i shtoi motivin skuadrës, e veçanërisht Altuna Francajt e cila vetëm gjashtë minuta më vonë realizoi golin e 6-të njëherit të fundit për këtë takim. Kosova në dy miqësoret kundër Malit të Zi shënoi 11 gola derisa nuk pranoi as edhe një nga kundërshtari. Kjo përgatitje dëshmon që "dardanet" janë gati për ndeshjet kualifikuese të cilat zhvillohen në fund të tetorit dhe në fillim të nëntorit në Shqipëri.

Kosova U18 me fitore e përfundon Botërorin

PRISHTINË, 23 GUSHT - Përfaqësuesja U18 e Kosovës në hendboll e ka përfunduar me fitore paraqitjen në Kampionatin Botëror në Chuzhou të Kinës. Të premten në mëngjes, sipas kohës në vendin tonë, Kosova fitoi ndaj Nigerisë me rezultatin 21:18. Ndeshja ishte e vlefshme për vendin e 23-të. Pra Kosova U19 ka përfunduar e 23-ta prej 32 ekipeve kombëtareve pjesëmarrëse në Botëror. Për hendbollistet tona të reja është paraqitja e parë në Botëror. Në fakt për herë të parë një ekip kombëtar i Kosovës në konkurrencë të sportisteve, në sportet ekipore, është kualifikuar dhe është paraqitur në Botëror. Dhe në pjesëmarrjen e parë nëntë ekipe kombëtare janë lënë prapa. Pjesa e parë e ndeshjes me Nigerinë ishte e fortë dhe e barabartë. Përfundoi 7:7. Në pjesën e dytë Kombëtarja jonë, përkundër telasheve me lëndime, shfaqi më tepër dhe arriti fitore. Kombëtarja jonë ishte vazhdimisht në epërsi dhe fitoi në fund me rezultat 21:18. Diona Dreshaj i shënoi 10 gola për Kosovën dhe u shpall më e mira e ndeshjes. Arjeta Imeraj, Orgesa Gola e Andra Uglani i shënuan nga 3 gola. Botërorin e parë të saj, Kosova U18 e përfundoi me tri fitore e katër disfata. Paraqitja në Botëror është sukses i madh i kësaj kombëtareje dhe hendbollit kosovar në përgjithësi. Përvoja në Kampionatin Botëror do të jetë përvojë me rëndësi shumë të madhe për karrierën e mëtejme të kësaj gjenerate, prej të cilës pritet shumë.

Superkupa e basketbollit zhvillohet në Prizren

PRIZREN, 23 GUSHT - Superkupa e Kosovës në basketboll do të organizohet në Prizren. Bazuar në kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që dalin nga Statuti, gjegjësisht neni 23, si dhe bazuar në Rregulloren e Punës së Bordit të FBK-së, më 23 tetor, pas mbylljes së konkursit, Bordi i FBK-së ka marrë vendim për organizimin e Superkupës së Kosovës në konkurrencën e meshkujve në qytetin e Prizrenit, në datat 7-11 Shtator 2024. Superkupa do të organizohet nga Federata e Basketbollit e Kosovës në bashkëpunim me KB Bashkimi. Eventi i basketbollit do të organizohet nga 7 deri më 11 shtator. Për pesë ditë radhazi do të jetë festë e basketbollit me tetë klubet e elitës së basketbollit të Kosovës. Qyteti i bukur dhe historik do të jetë mikpritës i tifozëve basketbolldashës, kurse palestra "Sezai Surroi" do të jetë arena e ndeshjeve të basketbollit, ku priten shumë sfida interesante nga çerekfinalet, e deri te finalja, më 11 shtator.

Ballkani krenohet me ish-futbollistët që luajnë në Evropë

SUHAREKË, 23 GUSHT - Kampionët e Kosovës në futboll, kanë postuar një video në faqen e tyre zyrtare në "Facebook", përmes së cilës kanë paraqitur momente të disa prej ish-futbollistëve, të cilët mbrojtën ngjyrat e FC Ballkanit. "Çdo moment është i përjetësuar, çdo përjetim është i paharruar, është histori e shkruar - Krenarë me ju djema", thuhet në postimin e suharekasëve. Protagonistët e kësaj video janë emra të njohur tashmë në kampionatet e ndryshme evropiane ku luajnë, duke qenë shpesh vendimtarë në triumfet e tyre. Mirlind Daku, Arbër Hoxha Jetmir Topalli, Ermal Krasniqi, Albion Rrahmani, Albin Berisha, Qendrim Zyba, Meriton Korenica, Nazmi Gripshi, Lumbardh Dellova, Edvin Kuç e Armend Thaqi, janë 12 lojtarët që veshën fanellën e portokall e zinjëve, para se të kalonin në liga më të forta futbollistike.

Gundogan rikthehet te City

MANCHESTER, 23 GUSHT - Manchester City ka konfirmuar zyrtarisht rikthimin e mesfushorit Ilkay Gundogan, i cili në sezonin e fundit luajti te Barcelona. Pas vetëm një sezoni në "Camp Nou", Gundogani ka vendosur të rikthehet në "Etihad Stadium", aty ku fitoi çdo trofe me Cityn. Është vetë faqja zyrtare e kampionit anglez që ka konfirmuar zyrtarisht rikthimin e mesfushorit gjerman, i cili arriti marrëveshje personale para disa ditësh. "Manchester City ka përfunduar një marrëveshje për të rinënshkruar Ilkay Gundogan nga Barcelona në një marrëveshje njëvjeçare", thuhet në njoftim. Transferimi i Gundogan nuk i ka kushtuar asnjë cent Cityt, pasi vjen si lojtar i lirë, ndërsa do ta mbajë veshur fanellën me numër 19. Gjatë periudhës së tij të parë të jashtëzakonshme në klub, gjermani fitoi pesë tituj të Ligës Premier, dy Kupa FA, katër Kupa të Ligës, dy Superkupa të Anglisë dhe një Ligë të Kampionëve. Ai me fanellën e "Qytetarëve" ka bërë 304 paraqitje, duke shënuar 60 gola dhe duke dhuruar 38 asistime.

Nagelsmanni e largoi Neuerin nga Kombëtarja e Gjermanisë

MUNCHEN, 23 GUSHT - Vazhdon të shkaktojë diskutime dorëheqja befasuese e Manuel Neuer nga Kombëtarja e Gjermanisë. Në veçanti, marrëdhënia e tensionuar me trajnerin e Kombëtares, vjen në fokus pas gjithë kësaj panorame. Sipas një raporti të "BILD", kontaktet mes kapitenit të Bayernit dhe trajnerit të kombëtares thuhet se kanë qenë shumë të rralla, pas humbjes së hidhur në çerekfinale të Kampionatit Evropian kundër Spanjës. Thuhet se nuk ka pasur asnjë bisedë me Nagelsmanni. Kjo marrëdhënie e tensionuar thuhet se kthehet në kohën kur Nagelsmanni ishte ende trajner i bavarezëve dhe pati një mosmarrëveshje me mikun e vjetër të Manuelit dhe trajnerin e portierëve Toni Tapaloviç. Tapaloviç u shkarkua me nxitjen e Julianit, gjë që rëndoi ndjeshëm në marrëdhënien mes tyre. Vetë Neueri mori vendimin e tij vetëm natën e së martës dhe e informoi Federatën Gjermane të Futbollit të mërkurën në mëngjes. Portieri

bavarez ua dha lamtumirë tifozëve në një video emocionuese në "Instagram": "Do të vinte kjo ditë në një moment të caktuar. Karriera ime me Kombëtaren gjermane të futbollit përfundoi". Ai theksoi se sa i vështirë ishte ky hap për të: "Të gjithë ata që më njohin e dinë që ky vendim nuk ishte i lehtë për mua". Edhe ata që e rrethojnë janë të befasuar nga vendimi i Manuelit. Kthimi i papritur befasoi shumë pasi më parë u raportua se portieri kishte në plan të vazhdonte karrierën me përfaqësuesen. Vendimi thuhet se ka shkaktuar habi edhe te rrethi i ngushtë shoqëror. Po sipas "BILD", disa burime madje donin të konfirmonin se Neuer kishte menduar të vazhdonte deri në Kupën e Botës 2026 dhe të dilte në fushë vetëm përgjatë ndeshjeve ndërkombëtare në shtator. Por në fund 37-vjeçari vendosi ndryshe. Nagelsmanni gjithashtu komentoi dorëheqjen e Neuer në një deklaratë: "Edhe nëse mund ta kuptoj vendimin e Manuelit dhe motivet e tij, largimi është një humbje e madhe sportive dhe personale". "Manuel i dha formë portierit si askush tjetër në historinë e futbollit".
Vetë Neueri bëri "homazhe" për kohën e tij si kapiten i ekipit kombëtar: "Të isha kapiten i kombëtares gjermane për më shumë sesa shtatë vjet, derisa u lëndova, diçka shumë e veçantë për mua". Pritet me interes nëse do ketë "shigjeta" në distancë mes Neueri dhe Nagelsmanni, teksa "xixat" e para kanë filluar të shfaqen në horizont.

Hearn: Joshua s'do të gjejë paqe deri sa të unifikojë sërish titujt kampionë bote

